



Datë: 08.07.2025
Numër Protokolli: 4580/2025

A.nr.891/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.891/2025, të datës 15.05.2025, të parashtruar nga ankuesi J.Z, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Rexhep Potera nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 08.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.891/2025, të datës 15.05.2025, të parashtruar nga ankuesi J.Z.

A r s y e t i m

Ankuesi J.Z (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesi*), më datë 15.05.2025, përmes përfaqësuesit me autorizim, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 28.04.2025, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për konkursin me Nr.ref:RN00016713, pozita Drejtor i Departamentit për Trajnim të të Burgosurve dhe të Miturve, të shpallur nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, ankuesi më datë 08.07.2025, përmes parashtrësës më numër protokolli 3166/2025, ka bërë tërheqjen e ankesës të datës 15.05.2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: 1. *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.891/2025 të datës 15.05.2025.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi, 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.891/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Rexhep Potera;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*